

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, në trup gjykues të përbërë prej gjyqtarit Gazmend Bahtiri-kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve porotë Naser Rama dhe Ruzhdi Zhugolli - anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të pandehurit N. Zh. nga fshati S.I, Komuna e P., në lëndën penale për rishikim të procedurës penale sipas Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KP.nr.265/2011 të datës 24.06.2011, për shkak të tri veprave penale të Vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1.pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë-tani Prokuroria Themelore Prishtinë, Departamenti përgjithshëm penal PP.nr.6792-4/2011 të dt.19.01.2012, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të datës 31.06.2013 të mbajtur në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore nga Prishtina-Armend Hamiti, të dëmtuarit A.P., të akuzuarit dhe të autorizuarit të tij av.F.Sh., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht në prezencë të mbrojtësit të akuzuarit shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

N.ZH., i biri i R. dhe nënës M. e vajzërisë M., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin S., Komuna e P. ku edhe jeton, me nr.personal:*numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion-bujk, i martuar baba i 15 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i dënuar me dënim me gjobë nga kjo gjykatë për vepër penale Mashtrimi, ka të dhëna nga kjo gjykatë se kundër tij zhvillohen edhe procedura tjera penale, shqiptarë-shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e:

I. Më datë 23.08.2004, gjatë natës të pandehurit F.H., R. H. dhe Sh.F. posa arritën te oborri i shtëpisë së të dëmtuarit A. P., në rrugën “...” në P., duke e thyer derën e oborrit hyjnë në oborr dhe posa kanë vërejtur traktorin e parkuar të markës “Ferguson”-IMT-539” me kabinë, të ngjyrës së kuqe e kanë shtyrë me dorë që të tretë disa metra dhe pastaj nëpërmes telave të kontaktit e kanë ndezur traktorin dhe e kanë drejtuar deri në arat e fshatit Sekiraj ku i kanë prit N. Zh. dhe B. E., e më pastaj N. së bashku me B. traktorin e kanë ngarkuar në kamionin e markës “Man” dhe e kanë dërguar në fshatin Dujak në Gjakovë ku i kanë shitur të pandehurit S. I. në shumën prej 2000€ dhe të njëjtë janë kthyer nga Gjakova dhe i kanë nda paratë, me ç`rast të dëmtuarit A.P. i kanë shkaktuar dëm në shumë prej 5000€. Më dt. 03.11.2004, nga ana e policisë traktori i markës “IMT”-539” me kabinë, ngjyrë të kuqe është gjetur në fshatin Dujak KK Gjakovë, tek i pandehuri S. I. i cili traktor është marruar dhe pas identifikimit i është kthyer të dëmtuarit I. P.

-Me këtë në bashkëveprim ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

II.Më datë 23.09.2004, pas mesnate të pandehurit F., R. dhe Sh. posa arritën te oborri i shtëpisë së të dëmtuarit R. U., në rrugën "...” KK P., janë ofruar afër traktorit të markës "IMT-539", e ngjyrës së kuqe me kabinë i cili ka qenë i parkuar para dritareve të shtëpisë që të tre e kanë shtyer me dorë janë larguar disa metra larg oborrit dhe me atë rasti i pandehuri F. përmes telave të kontaktit e ka aktivizuar traktorin, ndërsa i pandehuri Sh. e ka drejtuar traktorin deri në arën e mbjellur me misër në fshatin Sekiraq, ku i kanë pritur B. E. dhe N. Zh. e pastaj B. së bashku me N. traktorin e kanë ngarkuar në kamionin "Man" e kanë dërguar në fshatin Dujak dhe ia kanë shitur të pandehurit S.I. në shumën prej 2000 € dhe psa kthimit të pandehurit i kanë ndarë paratë në mes veti, me ç`rast të dëmtuarit R. U. i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 6000€.

-Me këtë në bashkëveprim ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

III.Me datë 02-03.10.2004, në mes të natës të pandehurit R.,F., dhe Sh.,posa arritën te oborri i shtëpisë së të dëmtuarit Sh. H. nga fshati Ll., KK P., duke kaluar pengesat e rrethojës së oborrit kanë hapur derën e garazhës , kanë marrë traktorin e tipit "IMT-539", ngjyrë e kuqe me kabinë, të cilët e kanë shtyer 30 metra larg oborrit, ku i pandehuri Sh. e ka aktivizuar traktorin mes telave të kontaktit dhe e ka drejtuar deri në arë në fshatin Sekiraqë, ku kanë qenë duke i pritur N. Zh. dhe B. E., e pastaji pandehuri N. dhe B. e kanë ngarkuar traktorin në kamionin "Man" dhe e kanë dërguar në fshatin Dujak KK Gjakovë dhe ia kanë shitur të pandehurit S.I. në shumë prej 2000€,pasi që janë kthyer nga Gjakova të pandehurit i kanë i kanë nda paratë në mes veti, me ç`rast të dëmtuarit Sh. H. i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 6000.

-Me këtë në bashkëveprim ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 3,34,38,64,71,73,të KPK-së si dhe në bazë të nenit 391 të KPPPK-së ,për secilën vepër veç e veç dënimet ia,

V Ë R T E T O N

Të akuzuarit N. (R.) Zh., nga fshati S., Komuna e P., për veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, siç përcaktohet në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, për veprën penale në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, po ashtu edhe për veprën penale në pikën III. të dispozitivit të aktgjykimit me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muajsh.

Me aplikimin e nenit 71 të KPK-së,

G J Y K O N

I.Të akuzuarin N. (R.) Zh., me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 1(një) viti e 6(gjashtë) muaj, dënim ky të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me

të cilin do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej **datës 05.11.2004 e gjerë më datën 02.02.2005.**

II.Në bazë të nenit 102 par.1 lidhur me nenin 99 par.1 dhe 2 nën par.6 të KPK-së, i akuzuari obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 100/njëqind/euro,në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

III.Të dëmtuarit A. P. nga P., rruga "...”pn.R. U. nga P., rruga "...” pn,dhe Sh.H. nga fshati Ll. e E., K.P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë-tani Prokuroria Themelore Prishtinë, Departamenti përgjithshëm penal, sipas aktakuzës, PP.nr.3242-7/2004 të datës 19.01.2005, ka akuzuar të pandehurit N.Zh.,B.E.,F. H.,R.H.,Sh. F., për shkak të tri veprave penale të Vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1.pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së,dhe S.I. për shkak të tri veprave penale të pranimit të mallrave të vjedhura nga neni 272, par.1 të KPK-së,me aktgjykimin e formës e Gjykatës Komunale në Podujevë P.nr.35/05 dt.17.03.2008,i akuzuari N.Zh. është shpallur fajtor dhe është gjykuar me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 7 muaj, të akuzuarin F. H. me dënim unik me kohëzgjatje prej 8 muaj,të akuzuarin R. H. me dënim unik në kohëzgjatje prej 7 muaj, të akuzuarin Sh. F. me dënim unik në kohëzgjatje prej 8 muaj dhe S. I. me dënim unik në kohëzgjatje prej 6 muaj. Më rastin e shqyrtimit të ankesës të PPK-së në Prishtinë, Gjykata e Qarkut në Prishtinë AP.nr 301/8 dt 16.10.2010, ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë ashtu që të pandehurit N. Zh.,F. H.,R. H. dhe Sh. F. secilin veç e veç gjykon me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 1(një) vite e gjashte (6) muaj, ndërsa kundër të akuzuarit S. I. refuzohet propozim akuza për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut KP.nr 265/11 dt.24.06.2011,hudhet si pabazuar kërkesa për rishikimin e aktgjykimit të formës së prerë sa i përket të dënuarit Sh. F. e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Podujevë,P.nr 35/05 dt.17.03.2008,ndërsa aprovohet si e bazuar kërkesa për rishikim të procedurës sa i përket të dënuarit N. Zh. dhe çështja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rivendosje, duke vendosur sipas kërkesës së mbrojtësit të gjykuarit N. Zh. për mbrojtje të ligjshmërisë Gjykata Supreme e Kosovës Pkl.nr 104/2011 dt.02.11.2011,ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë i paraqitet kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Podujevë dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, më aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë PN.nr.49/2011 dt.02.03.2012,hudhet kërkesa e mbrojtësit të dënuarit R. H. për rishikim të procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AP.nr.301/2011 dt.16.12.2010.

Përfaqësuesuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë—Armend Hamiti edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë në rigjykim të kësaj çështje penale e po ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se mbetem në tërësi pranë aktakuzës, duke theksuar se edhe njëherë u vërtetua fajësia se i pandehuri ka kryer këto vepra penale për të cilat ngarkohet, lidhur me deklaratën e bashkëpandehurit R. H. në cilësi të dëshmitarit ka theksuar se nuk

duhet t'i falet besimi sepse edhe vet e pranoi se nuk ka pasur presion nga askush për tu deklaruar në gjykatë, ndërsa sa i përket deklaratës së të pandehurit krahasuar me deklaratat e mëhershme, në polici, prokurori dhe gjykatë, ishte kundërthënëse dhe konfuze me, të gjitha ato i ka dhënë në prani të mbrojtësit të tij, nuk duhet tu falet besimi deklaratës se rishqyrtimit, dhe kërkoj nga gjykata ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Kjo Gjykatë, me rastin e vendosjes në rishikimin e çështjes penale (tani për herë të dytë vetëm sa i përket të akuzuarit N. Zh.) sipas aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë KP.nr.265/2011 të datës 24. 06.2011, mbajti shqyrtimin kryesor publik, ashtu që gjatë procedurës së provave ka dëgjuar: të akuzuarin, të dëmtuarin A. P., të ftuar në cilësi të dëshmitare: R.H., F. H., Sh.F., dhe janë lexuar: lista e marrjes së traktorit nga S. I. të dt.02.11.2004, lista e kthimit të traktorit të dëmtuarit A.P. dt.03.11.2004 si dhe fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, Procesverbali i dt. 16.12.2004 i deklaratës së të pandehurit R. H. të dhënë në PPK, dhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor mbajtur më datë 11.03.2008, në Gjykatën Komunale në Podujevë.

Këto prova gjykata i ka vlerësuar një nga një dhe të gjitha se bashku në lidhshmëri me njëra tjetrën në vështrim të nenit 387 par.2 të KPPK-së, dhe sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivat të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari A.P. në shqyrtimin gjyqësor deklaroi: se e bashkëngjitet ndjekjes penale dhe parashtrij kërkesën pasurore juridike, ndërsa Gjykata, në mungesë të dëmtuarve, R. U. dhe Sh. H. edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt, me qenë se të njëjtit nuk janë paraqitur dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar ka lexuar kërkesën pasurore – juridike.

R. H. i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, pasi që për të ka përfunduar procedura penale me aktgjykim të formës së prerë ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë deklaratës së dhënë me shkrim e cila është vërtetuar në Gjykatën e Graçanicës, dhe ka theksuar nuk ka qenë pjesëmarrës në vjedhje N.Zh. me arsyetim se deklaratën e dhënë në polici dhe prokurori që ka thënë po për shkak se ka pasur presion nga policët se si të deklaroi, ndërsa sa i përket deklaramit në gjykatë ka potencuar se nuk kam pasur presion nga policët si të deklaroj.

F. H. i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, pasi që për të ka përfunduar procedura penale me aktgjykim të formës së prerë ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë deklaratave të dhëna në polici, prokurori dhe në gjykatë dhe sa i përket N. Zh.

deklaroi se këtë person nuk e njoh dhe shtoi se flasin faktet i keni.

Sh. F. i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, pasi që për të ka përfunduar procedura penale me aktgjykim të formës së prerë ka deklaruar se nuk e njoh N. Zh. sepse nuk kam pasur kurrfarë kontakti me të dhe mbetem pranë deklaratave të dhëna në polici, prokurori dhe gjykatë.

I pandehuri N. Zh. në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare nuk e pranoi

fajsinë dhe në mbrojtjen e tij ka theksuar se nuk ka qenë fare prezent as për rastin e parë të vjedhjes, të dytë dhe të tretë, për traktorët të cilët janë paguar R. dhe F. H.,ka theksuar se B. E. është njohur përmes meje me S. I. të cilit ja ka shitur tre traktorët sa ka qenë vlera nuk e di, por unë kam përfituar sa i përket këtyre tri rasteve, dhe nuk e kam ditur se traktorët kanë qenë të vjedhur, për këta traktora e kam ditur se janë nxënë në kockë, në fajde sepse edhe unë vet e kam dhënë preklicën e traktorit që asnjëherë nuk e kam parë më në fajde, po ta dija se kanë qenë të vjedhur nuk do të kisha blerë, më këta persona ka kontaktuar vetëm B.,ka theksuar se kjo është e vërteta dhe ka shtuar se nuk di se qka kam deklaruar as në polici as në prokurori e as në gjykatë sepse kam qenë në stres.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit F. Sh. në fjalën e vet përfundimtare deklaroj, se në nuk është vërtetuar aktakuza, se kjo aktakuzë dhe i tërë aktgjykimi i mëparshëm është mbështetur në një provë që në bazë të nenit 155 par.1 nën par.3 nuk duhet të shërbejë si bazë për aktgjykim, deklarimi i R. H. qëndroj pranë deklaratës së dhënë me shkrim se ky rast juridiko-penal është rast i montuar nga policët S. M. dhe F. K., se deklarimi i tij i mëhershëm në polici dhe prokurori ka qenë i rrejshëm i bërë me sugjerimin e policëve të përmendur ku këtij të pandehuri i është premtuar përfitim i caktuar, më mos paraburgosje e tij që bazuar në dispozitat e kodit të procedurës penale për rastin konkret gjithsesi ka qenë i obliguar nga fakti se ky i akuzuar shihet se ka qenë akteri kryesor i këtyre vepra të vjedhjes, mirëpo për kundër të gjitha këtyre konsideroj se as në shqyrtimin e mëparshëm kryesor e as në shqyrtimin e sotëm nuk është vërtetuar se i mbrojturi im i ka kryer veprat penale të vjedhjes së rëndë për të cilat e ngarkonë aktakuza e PPK në Prishtinë, nëse shikohet përshkrimi ligjor i veprave në dispozitiv të aktakuzës shihet se asnjë nga këto vepra nuk vërehet se N. Zh. ka veprime të kryerjes së veprave penale, në të tri rastet konkrete veprat penale vjedhjes së traktorëve janë kryer në momentin kur traktorët kanë arritur të aktivizohen nga vendi ku kanë qenë dhe janë larguar nga aty,në këto pjesë të kryerjes së veprës penale pala ime mbas kësaj qka shihet në aktakuzë nuk ka kurrfarë veprimi, andaj sa i përket kësaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta liron nga akuza në mungesë të provave, i akuzuari N. Zh. në bazë të deklarimit të tij edhe në supozim se së bashku me B.E. i kanë blerë këta traktor ky nuk ka ditur se këta traktor kanë qenë të vjedhur duke mendur se traktorët janë zënë në kockë apo janë marrë me fajde nga fakti se siq ka deklaruar se e ka ditur se R. H. ka luar kockë në këtë drejtim në mungesë të nxjerrjes së faktit se janë të vjedhur nuk mund të konsiderohet se ka kryer vepër penale pranim i mallërave të vjedhura, po nëse gjykata gjenë se i akuzuari ka qenë në dijeni se këta traktor kanë qenë të vjedhur konsideroj se në rastin konkret i akuzuari nuk mund të shpallet fajtor pasi që për këtë vepër penale ka ardhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale,dhe i propozoj gjykatës që në supozim se gjene se është fjala për këtë vepër ,ndaj të akuzuarit të refuzohet akuza.

Nga lista e provave materiale të dt.02.11.2004,vërtetohet se është gjet dhe marrë traktori i vjedhur IMT 539 me ngjyrë të kuqe të cilin i pandehuri N. Zh. në bashkëveprim me B. E. ja kanë shitur S. I.,dhe nuk ka qenë kontestuese se edhe vetë i pandehuri në deklaratën e dhënë në polici dhe prokurori dhe gjykatë e ka pranuar se ju kanë shitur këtij personi.

Nga lista e provave materiale të dt.03.11.2004, vërtetohet se traktori IMT 539 Ferguson me ngjyrë të kuqe i është kthyer të dëmtuarit A. P..

Nga fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet ku është bërë vjedhja në shtëpitë e të dëmtuarve, e po ashtu nga fotodokumentacioni vërtetohet traktorët të cilët janë vjedhur.

Nga Procesverbali i dt.16.12.2004 i deklaratës të pandehurit-tani të gjykuarit R. H. të dhënë në PPK, në mënyrë shumë bindëse vërtetohet bashkëpunimi duke i ndar rolet në mes të pandehurve sipas aktakuzës në bashkëveprim kanë kryer veprat penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, i cili po ashtu edhe në polici dhe në seancën e konfirmimit dhe të shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar se në bashkëkryerje i kanë kryer veprat penale të datës 23.08.2004,të datës 23.09.2004,dhe 02-03.10.2004.si në dispozitivat e aktgjykimit.

Po ashtu nga përmbajtja e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 11.03.2008,në Gjykatën Komonale në Podujevë, vërtetohet se i pandehuri N. Zh. e ka pranuar veprën penale si në pikën I të aktakuzës dhe ka deklaruar se ndjen vetën fajtor se kinse ky me B. E. i kanë bler me datë si në dispozitivat e aktakuzës dhe nuk e ka ditur se traktorët kanë qen të vjedhur e të cilët e ka pranuar se ja kanë shitur tre traktor S. I. nga Gj., ndërsa S. I. në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar se ka blerë një traktor nga të pandehurit, po ashtu edhe tani i gjykuari Sh. F. e ka pranuar pjesërisht fajësinë vetëm për një vepër penale të vjedhjes, ndërsa i gjykuari F. H. nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale.

Gjykata vërtetoi gjendjen faktike nga përmbajtja e deklaratave të bashkëpandehurve sipas aktakuzës së PPK,PP.nr.3242-7/2004 të datës 19.01.2005, të cilët janë gjykuar me aktgjykim të formës së prer, dhe të pandehurit N. Zh., i cili në shqyrtimin gjyqësor i ka pranuar pjesërishtë veprat penale, R. H. i cili në deklaratën e dhënë në polici, në prokurori, në seancën e konfirmimit dhe në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar në tërësi se në bashkëkryerje me N. Zh.,B. E.,F. H. dhe Sh. F. në bashkëveprim kanë kryer veprat penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së,dhe Sh. F. i cili në të gjitha fazat e procedurës penale e ka pranuar fajësinë pjesërisht, e po ashtu edhe S. I. në gjitha fazat e procedurës e ka pranuar se ka blerë një traktor nga të pandehurit si dhe provave materiale të administruara e që gjinden në shkresat e lëndës, siq janë lista e marrjes të sendeve të dt.02.11.2004, dhe lista e kthimit të sendeve të dt.03.11.2004 dhe fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, prandaj gjykata pa mëdyshje është e bindur se i akuzuari N. Zh. është bashkëkryerës i veprave penale për të cilat akuzohet, andaj edhe ua fali besimin këtyre provave gjë që për gjykatën ishin të mjaftara dhe si prova bindëse.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit N. Zh. përmbushen të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprave penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së,si në dispozitivat nënë I.II.II të aktgjykimit për të cilat vepra penale gjykata edhe shpalli fajtor pasi që gjeti se është përgjegjës dhe e gjykoi si në dispozitivë të këtij aktgjykimi.

Duke vlerësuar deklaratën me shkrim të datës 28.04.2011 e vërtetuar në Gjykatën Komonale Prishtinë-Dega Graçanicë,të gjykuarit R. H., i cili ka theksuar se kinse ka pasur presion në polici dhe prokurori nga pjestart e policis si të deklaroj, kjo gjykatë e ka vlerësuar duke hedhur poshtë si të pa vlefshme dhe të pa pranueshme, dhe në kundërshtim me deklaramet e tij të më hershme dhëne në polici, prokurori në seancën e

konfirmimit të aktakuzës,dhe në shqyrtimin gjyqësor, nga se kjo u vërtetua me deklaratën e tij dhënë në rishqyrtimin gjyqësor e i cili ka theksuar se në gjykatën kur është deklarua nuk ka pasur presion nga askush,ashtu që në seancën e konfirmimit të aktakuzës dhe në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar se i kane krye tri veprat penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje edhe me N. Zh., dhe ka mbet pranë deklaratave në polici, prokurori dhe gjykatë, ashtu që nuk mund ta arsyetoj ndryshimin e qenësishëm të deklaramit të tij nga se në polici dhe para prokurorit, kur është mar në pyetje iu kanë garantuar liritë dhe të drejtat themelore, privilegjet që ika i akuzuari sipas nenit 231 të KPPPK-së, për të drejtën e mbrojtjes në heshtje, te drejtën që të mos përgjigjet në pyetje të caktuara edhe në rast se mbrojtjen e jep gojarisht dhe vërejtjen se deklarami i tij mund të përdoret si provë para gjykatës, në këtë pikëpamje deklarimet e tij në polici prokurori kanë validitet procedural në mbështetje edhe të nenit 156 lidhur me nenin 372 të KPPPK-së, ashtu që me atë deklaratë ka pretenduar dhe ka pasur për qëllim që ta shfajësoj nga përgjegjësia penale të pandehur N. Zh., gjykata nuk ja ka fal besimin dhe ka hedhur si provë të pa pranueshme.

Mbrojtjen e të akuzuarit, gjykata e ka vlerësuar duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga gjykata, nga deklarata e dhënë në rishqyrtimin gjyqësor, dalin mospërputhje dhe kontradiktore me deklaratat e dhëna në polici prokurori dhe gjykatë, edhe pse në prezencën e avokatit mbrojtës, ashtu që akuzuari me këtë deklaram ka pasur për qëllim që ti ikë përgjegjësisë penale për veprat penale të cilat i vihet në barrë.

Gjykata tezen e mbrojtësit av.F. Sh. e ka vlerësuar duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara në procedurë,pretendimt e tij për shpallejn e proves së pa pranushme të gjykuarit R. H. në kuptim të nenit 155 par 1 dhe 3 të KPK-së, trupi gjykues e ka hudhur posht me arsyetim se në rigjykim R. H. deklaroj se në gjykatë nuk kame pasur presion nga askush si me deklaruar,e po ashtu gjykata konstaton se deklarata e dhënë në prokurori ju kanë garantuar liritë dhe të drejtat themelore dhe privilegjet që i ka i akuzuari sipas nenit 231 të KPPPK-së ,e po ashtu pretendimet e tij se në veprimet e të pandehurit më shumë i ngjasojnë veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par 1 të KPK-së, gjykata e ka hedhur posht,nga se i pandehuri me veprimet e tij ka pasur rol aktiv në bashkëveprim për kryerjen e veprave penale të vjedhjes së rëndë, me të pandehurit e tjerë që vërtetohet me deklaratën e R. H. dhënë në polici, prokurori dhe gjykatë.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së,dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësorë ishte korrekt, familjarë baba i 15 fëmijëve,duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata mori parasyshë se i njëjti është përsëritës i veprave penale të ngjajshme i gjykuar nga kjo gjykatë për veprër penale mashtrimi,dhe ndaj zhvillohen edhe procedura tjera penale,e po ashtu mënyra dhe koha e kryerjes së veprës penale është shqetsuese, ku është krijuar një pasiguri e madhe e shoqësis në Kosovë,se ky lloj i veprave penale është bërë dukuri e shpeshtë në vendin tonë, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe e gjykoi me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 1(një) viti e 6(gjashtë) muaj, dënim ky të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, më të cilin do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2004,e gjerë më datën 02.02.2005,konsideroi se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmëris shoqërore të veprës penale si dhe përgjegjësisë penale dhe se

me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij dhe si masë parandaluese me efekt në persona të tjerë për moskryerjen e veprave penale e të parapara sipas dispozitës së nenit 34 të KPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar u muar në bazë të nenit 73 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mur në bazë të nenit 102 par.1 lidhur me nenin 99 par.1 dhe 2 nën par.6 të KPK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuararve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 112 par.1 dhe 2 të KPPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 391 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.333/12,datë 31.05.2013

Sekretare Juridike
Mihrie Sheholli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.